



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 137, datë 30.09.2025

PËR

**MIRATIMIN E SHOQËRISË “GRANT THORNTON” SH.P.K., SI SHOQËRI
AUDITUESE PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHOQËRISË
“REGJISTRI SHQIPTAR I TITUJVE ALREG” SH.A., PËR VITIN FINANCIAR 2025**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të Ligjit nr. 62, datë 14.05.2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, si dhe të Rregullores nr. 92/2023 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërisë komisionere dhe institucioneve të tregut”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e shoqërisë “Grant Thornton” sh.p.k., si shoqëri audituese për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë “Regjistri Shqiptar i Titujve, ALREG” sh.a., për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2025.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Saimir TOLA**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI**